



Republika e Kosovës



Komuna e Istogut

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË PËR FURNIZIM

(ME NJË OPERATOR EKONOMIK)

KOMUNA E ISTOGUT, Njesia e Prokurimit te cilën e përfaqëson Menaxheri-ja e Prokurimit z-nja Zizë Bujupaj, Adresa Rruga “Fadil Ferati” nr 121. Me nr. tel 038 200 43 858, ne cilësinë e porositësit te sherbimeve të Autoritetit Kontraktues në njëren anë;

dhe

“ACCES SOLUTIONS” me pronar z. Alije Murati Komuna e Prishtinës, me Nr. U nik Identifikues: 810848715, ne vazhdim “FURNITORI”, në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet si më poshtë:

FURNIZIMI ME PELET PËR NGROHJE PËR NGROHJE NEVOJA TË INSTITUCIONEVE SHENDETSORE NË ISTOG

Nr. I prokurimit	633-20 - 152-1-2-1/
Nr. I brendshëm	633 / 20 / 001/ 121

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontrate publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për FURNIZIMET si në vijim:

1.2 FURNIZIMI ME PELET PËR NGROHJE PËR NGROHJE NEVOJA TË INSTITUCIONEVE SHENDETSORE NË ISTOG

Autoriteti Kontraktues bënë (BLERJEN) Furnizimin vetëm në emër të vetë Autoritetit

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të kryej në bazë të kësaj kontrate publike kornizë,

duhet që të dërgojë “porosinë” tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative që Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të kryejnë furnizime të përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi më NËNSHKRIMIN E SAJË PËRKATËSISHT ME DATË **02.03.2020** DHE DO TE PERFUNDOJË ME SË LARTI DERI ME **02.03.2021** PASI KONTRAKTORI TE SJELLË DESHMËNË MBI SIGURINË PER EKZEKUTIMIN E KONTRATËS ME VLEFSHMËRI PREJ **13** MUAJVE, NGA DATA E NËNSHKRIMIT TË KONTRATËS.

1.5 Kjo kontratë mund të shkëputet edhe para skadimit të afatit të paraparë në Nenin 1.4 të kësaj kontrate, po që se kontrata permbushet me çmimin e paraparë sipas dispozitave të Nenit 56.10 të Udhëzuesit Operativ ku Citohet se “nese kontrata permbushet me çmim pa marre parasysht Kohën e zgjatjes dhe nenshkriin original e njëjta shkeputet automatikisht”

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim dhe kryerjen e të gjitha **FURNIZIMEVE** do të jetë: **13. 05. 2021** si afat I skadimit të afatit të kontratës.

2.2 Vendi ku do të dorëzohen artikujt do të jenë **INSTITUCIONET SHENDETSORE TE ISTOGUT. Shkollat, Qerdhet e fëmijeve dhe QKMF-ja**

2.3. Obligimet e kontraktorit janë të gjitha furnizimet të përcaktuara në Nenin 2.1 e dosjes së tenderit dhe kushteve të përgjithshme dhe të veqanta të kontratës.

2.3 Inkotermi I zbatueshëm do të jetë **DDP¹** (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të tyre. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet për njësi të furnizimeve janë të paraqitur në Ofertën Financiare, nga kryesi i furnizimeve i dates: **10.02.2020** dhe është: **1 ton = 165,00 €**

Vlera indikative e kontratës për periudhën **13** Muajshe është: **12.000,00 € me devijim (+ - 30 %)**

Dhe me shkronja: /Dymbëdhjetëmijëeuro/

4.2 Çmimi i përmendur për NJËSI në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh kontraktorit sipas kontratës publike kornizë.

4.3 [Çmimet per njësi janë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë kornizë

4.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

4.5. Në këtë rast nuk aplikohet

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

Plani per menaxhimin e kontrates

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tijë.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:
Komuna e Istogut:

Për Kontraktuesin:
Shpk ACCES SOLUTIONS"

Emri:	<i>Zizë Bujupaj</i>	Emri: <i>PER</i>	<i>Alije Murati</i>
Pozita:	<i>Zyrtar përgjegjës i Prokurimit</i>	Pozita:	<i>D r e j t o r</i>
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	<i>03.03.2020</i>	Data:	<i>03.03.2020</i>
Vula:		Vula:	